

AKTIVIZOHEMI PËR KOMUNITETIN

UNË PUNOJ
PËR
SHTETIN
TIM


E ARDHMJA
ËSHTE
NË DUART
TONA



TE BASHKUAR
PËR
NDRYSHIM

DEMOKRACINË E NDËRTON POPULLI AKTIV

VALZA (10), LEONA (10), ANISA (10), ERINDA (11), DIAMANTA (10), EGZON (10), LORETA (10),
ALBINOT (10), SHPAT (10)



A keni menduar ndonjëherë se kush e zhvillon shtetin demokratik? A janë qytetarët aktiv apo pasiv ata të cilët e bëjnë këtë zhvillim? Këto informata do t'i merrni në artikullin e mëposhtëm

Siç e dijmë të gjithë, demokracia është shfaqur në shekullin e VI-të para erës sonë, përkatësisht në vitin 507 p.e.s. në Athinë, në kryeqytetin e Greqisë. Koha për të cilën po flasim, ishte fillimi i shfaqjes së demokracisë. Në atë kohë nuk është marrë parasysh zbatimi i vlerave demokratike. Ky tranzicion, që tashmë e

çdo aspekt të jetës. Edhe shteti ynë Kosova, që nga viti 2008 është shtet i pavarur dhe demokratik. Nëse e krahasojmë se sa janë zbatuar elementet e demokracisë në vitin 2008 dhe sa zbatohen tash, do të shohim se ka dallime të dukshme në këtë aspekt. Tërë këtij zhvillimi i ka paraprirë vullneti i madh i qytetarëve të Kosovës. Por, vlen të theksohet se ende ka hapësirë për të vepruar dhe për t'u treguar qytetarë të përgjegjshëm. Prandaj, edhe ne si nxënës të vegjël që jemi, mundohemi që me shkathtësitë dhe njohuritë tona të aktivizohemi dhe të bëjmë ndryshime pozitive në vend. Këtë e realizojmë duke u përfshirë në aktivitete të ndryshme me karakter humanitar.

Ne jemi duke provuar të bëhemi model i qytetarëve të tjerë. Se si jemi duke realizuar këtë, vazhdoni ta lexoni artikullin tjetër, ku kemi përfshirë disa shembuj se si kohëve të fundit kemi qenë aktiv. Shpresojmë se do t'iu ndihmojnë ta kuptoni edhe më mirë rolin tuaj në shtetin ku jetoni.



Jemi shumë të lumtur që mësojmë për demokracinë

ka kaluar demokracia, ka ndodhur falë punës aktive që qytetarët e kanë bërë dhe vazhdojnë ta bëjnë për vite me radhë. Kjo nënkupton se qytetarët kanë filluar t'i vënë në pah shkathtësitë e tyre për zhvillimin e komunitetit ku ata jetojnë. Vetë fakti që sot qytetarët gëzojnë shumë liri dhe të drejta, dëshmon se përgjegjësia iu takon pikërisht atyre ta ngrisin vlerën e demokracisë. Këtë e bëjnë duke dhënë kontributin e tyre në




Ne e dijmë rëndësinë e aktivizimit qytetar


IDE TË TONA I TRANSFEROJMË NË VEPRA

Kohëve të fundit, unë së bashku me klasën time, jam bërë pjesë e disa aktiviteteve. Këto aktivitete kishin për qëllim promovimin e punës që duhet ta bëjnë qytetarët aktiv brenda shtetit të tyre. Synim kryesor i këtyre aktiviteteve ka qenë mbledhja e parave për t'i blerë disa uniforma për nxënësit e shkollës sonë

Dje ishim pjesë e një iniciative shumë të mirë, ku ideatore e saj ishte mësuesja e klasës sonë, së bashku me të gjithë ne. Për këtë, ne vendosëm që të bëjmë mbledhjen e parave duke shitur disa produkte ushqimore, të cilat i kanë përgatitur nënat tona. Parat e mbledhura do t'i shfrytëzojmë për uniformat që do t'i përdorim në shkollë. Iniciativën tonë e kemi realizuar në sheshin „Nënë Tereza“ në Prishtinë, ku kishte edhe shumë të interesuar. Përmes veprimeve në fjalë, kemi arritur të bëjmë mbledhjen e parave dhe të sigurojmë uniforma për të gjithë nxënësit të cilët kanë nevojë, por që nuk kanë mundësi t'i blejnë. Ky aktivizim përveç që na ka sjellur neve nxënësve dobi, ka aktivizuar edhe nënat tona dhe të gjithë qytetarët që ishin të pranishëm dje në shesh. Kjo bëri që shumë qytetarë të shohin se si duhet të aktivizohemi për shtetin tonë.



Shkolla është institucion shumë i rëndësishëm për ne




Leximi na ndihmon që të fitojmë njohuri



Përmes medias, informohemi për gjithçka që ndodh në botë



Idefë tonë ndikojnë në zhvillimin e vendit



Së bashku i realizojmë idetë që i kemi për të ardhmen

LIGJET DALIN NGA SHTËPIA E POPULLIT


ESMA (10), ELVIRA (10), ELDA (10), VALMIR (10), LORESA (10), ANA (10), ANISA (10), IRISA (11)



Qeveria propozon shumicën e ligjeve, ndërsa Kuvendi i miraton ato

Ne jetojmë në një botë përplot rregulla, të cilat janë shumë të dobishme për të pasur një jetë më të mirë. Ne kemi rregulla në shtëpi, në shkollë, si dhe në lagje. Gjithashtu, kemi rregulla edhe në shtetin ku jetojmë, pra, në Kosovë.

Në shtëpinë e shoqes sonë Anisë, ekziston një rregullë shumë e rëndësishme. E gjithë familja e saj zg-



Valmiri në rolin e Prokurorit

johet në orën 07:00 të mëngjesit. A e dini përse e kanë këtë rregullë? Sepse është më e shëndetshme të zgjohesh herët duke ditur se në mëngjes është edhe ajri më i pastër. Por, po ashtu, sa më herët që zgjohemi, aq më të kthjellët do të jemi. Gjithashtu, kemi dhe një rregullë në klasën tonë. Ajo është të flasim me radhë, sepse në atë mënyrë ne e tregojmë edukatën tonë dhe

respektojmë njëri-tjetrin.

Kuvendi është institucion, prej të cilit dalin rregullat e vendosura për të gjithë shtetin. Këto rregulla ne i quajmë ligje. Miratimi i ligjeve në Kuvendin e Kosovës bëhet me anë të votave të deputetëve.

Deputetët janë përfaqësuesit tanë, të cilët edhe marrin vendime në emrin tonë. Kuvendi i Kosovës gjithsej ka 120 deputetë, prej të cilëve 100 janë shqiptarë dhe 20 të tjerë iu takojnë komuniteteve jo shumicë. Këto komunitete janë: serb, goran, egjiptian, romë, ashkali dhe ai turk. Deputetët nuk votojnë vetëm për miratimin apo mos miratimin e ligjeve, por ata votojnë edhe për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, zgjedhjen e Presidentit, të Qeverisë, etj. Sot mësuam shumë gjëra. Prej tyre mësuam edhe për rëndësinë e ligjeve.

Prandaj, ne kemi një mesazh për lexuesit e artikullit tonë. Ne u themi të gjithë lexuesve se ligjet janë për ne, prandaj edhe duhet t'i respektojmë kudo që jemi.



Edhe ne si gazetarë të Kuvendit, i respektojmë ligjet

NE BËJMË NDRYSHIMIN

ARLIND M. (10), ARLIND H. (11), ARNESA (10), LEA (10), RINESA (10), RINA (10), JETMIR (10),
LEONORA (11)



Jemi të lirë të zgjedhim gjërat që dëshirojmë

Demokracia është formë e qeverisjes, në të cilën ka liri dhe barazi. Pra, është një sistem ku ne mund të shprehim lirishëm mendimet tona.

Alea është një vajzë 10 vjeçare, të cilës i pëlqejnë shumë librat. Një ditë, Alea shkoi në bibliotekë. Ajo dëshoi ta merrte një libër, por nuk dinte cilin ta zgjedhte, „Veroren“ apo „Liza në botën e çudirave“. Ajo u mendua dhe në fund e zgjodhi atë libër të cilin e pëlqente më shumë, i cili ishte „Verorja“. E mori dhe e lexoi atë, sepse Alea e ka të drejtën e zgjedhjes.

Gjatë një dite tjetër, në nxënësit e klasës, dëshironim të luanim një lojë. Por, ishim në dilemë për lojën që dëshironim të luanim. Nuk dinim a të luanim pikado apo „nata-dita“. Vendosëm që lojën ta zgjedhnim me mënyrën më demokratike, me vota. Disa nga ne votuan për pikado dhe disa të tjerë për „nata-dita“.

Përfundimisht u zgjodh pikadoja, sepse kishte vota më

shumë. Populli në demokraci, njësoj i zgjedh përfaqësuesit e tij me anë të votave. Këta përfaqësues pastaj marrin vendime, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në jetën tonë. Prandaj, roli ynë në shoqëri është shumë i madh dhe ne duhet të mendojmë mirë para se të zgjedhim e të marrim vendime në situata të caktuara. Pra, të mendojmë mirë para se të veprojmë diçka.



Ne kemi zgjedhur lojën që dëshironim ta luanim



Jemi të lumtur, sepse jetojmë në një vend ku ka liri



E ardhmja e vendit jemi ne



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Zenel Hajdini“
Klasa: V-5
Vendi: Prishtinë